



KOMUNA E KLINËS
KUVENDI I KOMUNËS

01. Nr. 06-599/18

PROCESVERBAL

I SEANCËS SË JASHTËZAJKONSHME TË KUVENDIT TË KOMUNËS, MBAJTUR,
MË 28.12.2017, NË ORËN 10.00, NË SALLËN E KUVENDIT TË KOMUNËS

Në seancë prezantuan: Kryesuesi i Kuvendit, Fadil Gashi, kryetari i Komunës, Prof. Dr. Zenun Elezaj, nënkryetari i Komunës, Besim Hoti, anëtarët e Kuvendit, drejtorë të drejtorive komunale, Zyra ligjore, KFOR-i, OSBE, ZKKZ, OJQ "Koha", mediet, qytetarë etj.

Seancën e udhëohqi kryesuesi i KK, Fadil Gashi, i cili fillimisht i uroi të pranishmit dhe ju dëshiroi mirëseardhje në këtë seancë të jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Klinës.

"Materialin anëtarët e Kuvendit e kanë marrë me kohë. Duke kiu referuar LVL, Rregullores së Punës së Kuvendit të Komunës, seancat e jashtëzakonshme thirren nga Kryetari i Komunës ose nga 1/3 e Kuvendit të zgjedhur. Dhe këtë seancë e kemi të thirrur nga Kryetari i Komunës, z. Elezaj, dhe rendi i ditës, po ashtu parashihet që seancat e jashtëzakonshme t'i hartojë ai që i thërret, rezervoni caktimin e rendit të ditës. Prandaj, më lejoni që të futemi në seancë", theksoi kryesuesi Gashi, i cili në vijim prezantoi procedurat mbi thirrjen e seancës së jashtëzakonshme të KK-së.

Në vijim kryesuesi Gashi prezantoi rendin e ditës dhe vuri në miratim rendin e ditës.

Me vota unanime u miratua ky

RENDI I DITËS

1. Shqyrtimi i mungesave,
2. Dhënie e betimit të anëtarit të Kuvendit të Komunës, Avni Gashi,
3. Njoftimi i Kuvendit të Komunës me emërimin e Nënkryetarit të Komunës dhe drejtorëve të drejtorive komunale.

Pika e parë: Arsyetimi i mungesave.

Kryesuesi sqaroi prezencën e 25 anëtarëve të Kuvendit që janë këtu, dhe 2 që mungojnë, njërin e kemi këtu, por s'mund të jetë anëtar i Kuvendit se ka paraqitur dorëheqjen, Skënder Merturi.

Pika e dytë: Dhënia e betimit të anëtarit të KK, Avni Gashi.

Avni Gashi, lexoi Deklaratën solemne të betimit.

Avni Gashi, uroi Kryetarin e Komunës, Zenun Elezaj dhe Kryesuesin e KK, Fadil Gashi, si dhe anëtarët e KK, duke iu dëshiruar suksese dhe mbarësi në angazhimet me plot përgjegjësi, po ashtu, anëtari Gashi përçoi mirënjohje për mirëkuptimin që kanë pasur lidhur me rastin.

Fadil Gashi, theksoi se në emër timin dhe tuajin i uroj punë të mbarë anëtarin Avni Gashi.

Pika e tretë: Njoftimi i Kuvendit të Komunës me emërimin e Nënkyetarit të Komunës dhe drejtorëve të drejtorive komunale.

Kryesuesi i Kuvendit fjalën e barti te Kryetari i Komunës, Zenun Elezaj, për njoftimin e emërimit të Nënkyetarit të Komunës dhe drejtorëve të drejtorive komunale.

Në vijim të seancës, kryetari i Komunës, Zenun Elezaj, ka bërë të ditur emrat e nënkryetarit dhe drejtorëve komunalë që do të jenë ekipi i tij në qeverisjen e Klinës nga koalicioni AAK, LDK, LVV dhe Nisma. Në kuadër të përgjegjësisë dhe kompetencave jam zotuar që në bashkëpunim edhe me koalicionin e bashkëqeverisjes për ta bërë përzgjedhjen më të mirë për drejtorë të drejtorive, ndërsa z. Besim Hotin e emëroj për Nënkyetar të Komunës:

**Besim Hoti (LDK) – Nënkyetar i Komunës,
Binak Sylaj (AAK) - Drejtor i Administratës,
Hekuran Sejdiu (AAK) - Drejtor i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale,
Arben Limanaj (LDK) - Drejtor i Arsimit,
Aziz Desku (LDK) - Drejtor i Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit,
Lorenc Marleku (AAK) - Drejtor i Urbanizmit dhe Mbrojtjen e Mjedisit,
Naser Morina (NISMA) - Drejtor i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural,
Iber Elezaj (LVV) - Drejtor i Shërbimeve Publike dhe Emergjente,
Petrit Beka (LDK) - Drejtor i Inspektoratit, Njomza Grabanica (AAK)- Drejtore e Kadastrës, Gjeodezisë dhe Pronësisë,
Skënder Merturi (LVV) -Drejtor i Kulturës, Rinisë dhe Sportit.**

Zenun Elezaj, tha se të zgjedhurve ju uroj suksese. “Bashkërisht do të bëjmë përpjekje t’i kryejmë detyrat me kompetencë dhe përgjegjësi”, pohoi ndër të tjera Kryetari Elezaj.

Fadil Gashi, tha se edhe unë i bashkohem urimit të suksesit të ekzekutivit, nënkryetarit dhe gjithë drejtorëve, me kërkesë të veçantë për anëtarët e Kuvendit që të mos jenë fort të disiplinuar në kërkesat e tyre, me interpelancat e tyre, me pyetjet e tyre dhe besoj fort që keni edhe mbështetjen e kryetarit dhe prezenca e drejtorëve nuk ka për të munguar në seancat e Kuvendit. Edhe një herë urime të gjithëve!” ka shtuar kryesuesi Gashi.

Fadil Gashi, theksoi se meqë është njoftim, pasi që kemi premtuar demokraci e mirëfilltë, Enver Berisha e ka fjalën.

Enver Berisha: “Fillimisht në emër timin dhe grupit parlamentar të PDK-së uroj kryetarin më gjithë të zgjedhurit e emëruar, që sot kanë filluar mandatin e tyre, duke shpresuar dhe besuar që do të jenë në shërbim të qytetarëve të komunës sonë. Por një gjë dua ta them që ne si opozitë do të ndjehem mirë po që se do të bëhen punë të mira në komunën tonë që janë në interesin e qytetarëve të komunës. Jam i detyruar dy gjera për t’i thënë: E para se do të jeni në kujdes për aq sa zhvillimeve që kanë për të ndodhur në Komunën e Klinës në ato procese që ne bashkërisht i kemi pasur dhe po ju premtoj se kemi për ta pasur një ndryshim. Nëse një pjesë e asamblistëve që sot janë në këtë sallë dhe që kanë marrë mandate të reja, të cilët janë shërbyer me ide dhe me fjalë të rrugëve edhe ato projekte dhe ato procese që kanë ndodhur në jetën e qytetarëve tanë nuk i kanë pranuar, por janë munduar gjithherë për t’i linçuar, ne do të veprojmë ndryshe. Ne do të mundohem atëherë kur ju s’e keni mirë me ndërruar qasjen për ta bërë mirë. Kështu që, edhe një shqetësim dua ta them këtu para jush: Unë jam i vetëdijshëm nga kryetari i Komunës i deritanishëm Sokol Bashota dhe unë dhe drejtorë tjerë kemi bërë pranim-dorëzimin e detyrave. Dhe besoj që e kemi bërë në mënyrën më të duhur dhe më të dinjitetshme. Por, po e lus kryetarin apo cilindo tjetër, se ofendimet që janë bërë në seancën e kaluar GP të PDK-së me daljen nga salla dikush është mirë për të kërkuar falje për ato fyerje që janë bërë. Dhe, po e them qysh sot, nga Kryetari dhe pozita, pozita nuk ka nevojë që të ndjehet keq për veprimet që ne i bëjmë, ajo është e drejtë jona. Ne vlerësojmë cili është vendimi apo veprimi më i mirë, kështu që ato që ne i ndërmarrim, ne mbajmë përgjegjësitë. Unë edhe një herë në fund, uroj punë të mbarë, uroj suksese të fundvitit, Krishtlindjet dhe Vitin e Ri 2018, dhe shpresojmë që në vitin 2018 fillon një fazë e re edhe për ju, edhe për ne. Ju faleminderit!”- ka theksuar kryetari i GP të PDK-së.

Fadil Gashi, tha se nuk na besofshi kur flisnim ne si opozitë. “Seanca është e jashtëzakonshme. Unë e thashë në fillim, për hir gjithçkahit ne jemi dakorduar, me qenë seanca të mira. Unë ja dhashë fjalën opozitës, se këta na ndaleshin. Debat s’ka. Mirë është për t’u mësuar në opozitë, nuk është keq edhe në opozitë. Një kërkesë kam për anëtarët e Kuvendit, herëve tjera kur të fillojmë prej janarit, fillimisht kur të hyni në sallë, ju kisha lutur te shërbimi regjistrohuni, sepse se po vonohem pastaj me fillim të seancave. Në hyrje fillimisht e bëni regjistrimin te shërbimi, i nënshkruani regjistrat, edhe fillojmë pastaj me seancat e rregullta. E dyta është që duke ju uroj të gjithëve që jeni këtu në këtë sallë edhe ata që s’janë, gjithë qytetarët e Komunës së Klinës, Urime Viti i Ri 2018, suksese për Ju, personalisht familjet e juaja, punën e juaj, bashkërisht në shërbim të qytetarëve të Komunës së Klinës”, ka konstatuar kryesuesi Gashi.

Më lejoni që ta shpallë të mbyllur seancën e jashtëzakonshme.

Seanca përfundoi në orën 10:25 minuta.

Procesmbajtësi,
Mikel GOJANI

